



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:206415

Datë: 30.04.2021

Numri i dokumentit: 01753135

P.nr.992/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani, me asistimin e praktikantës Kaltrina Namani në cilësinë e procesmbajtëses, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.B me vendbanim në Ferizaj për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar me numër: PP.II.nr.1546-11/2019 e datës 16 Shtator 2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Ajtene Zoni, si dhe të akuzuarit me datë 07 Prill 2021 mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 30 Prill 2021, përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

N.B: i lindur me datë..., nga i ati N. dhe e ëma E. e gjinisë Sh., me vendbanim në Ferizaj, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion punëtor fizik, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal...

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 05.12.2017, në kohë të pa caktuar, në zyrën për patentë shofer në Shtime, i pandehuri ka vënë në lajthim organin kompetent në atë mënyrë që ka prezantuar një dokument publik dhe

ka arritur të vërtetojë një çështje të pavërtetë, ku i pandehuri ishte i pajisur me patentë shofer të Polonisë me nr.... të njëjtën patentë shofer kishte arritur ta bëj përkthimin në patente shofer të Republikës së Kosovës me nr....., dhe pas verifikimit nga Ambasada Polake në Shkup ka rezultuar se ky patentë shofer është i falsifikuar dhe nuk ishte regjistruar në asnjë institucion atje,

- **me të cilin veprim ka kryer veprën penale legalizimi i përmbajtjes se rreme nga neni 403 par.1 të KPRK-ës.**

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve 2, 4, 7, 8, 17, 21, 41, 42, 49, 50, 51, 52 dhe 73 të KPRK-ës, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453,463, të KPP-ës, të akuzuarin e,

G J Y K O N

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht.

E dëmtuara Ministria e Punëve të Brendshme- Agjencia e Regjistrimit Civil në Republikën e Kosovës për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 115 par.2 të KPP-ës, konfiskohet në mënyrë të përhershme patentë shoferi i të akuzuarit i lëshuar nga R.Kosovës me numër ...

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë /Euro, si dhe në bazë të nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, të gjitha brenda afatit prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese në çështjen penale kundër të akuzuarit N.B me vendbanim në Ferizaj për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 1546-11/2019 e datës 16 Shtator 2019, ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 06 Korrik 2020, në prezencën e prokurorit të shtetit, si dhe të akuzuarit.

Në shqyrtimin fillestar, pas leximit të aktakuzës së prokurorit të shtetit, i akuzuari është deklaruar i pafajshëm për veprën penale për të cilën akuzohen.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, duke vepruar sipas kësaj çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 17 Nëntor 2020, në të cilin i akuzuari është deklaruar i pafajshëm, si dhe vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor me datë 22 Mars 2021 dhe 07 Prill 2021, në të cilën shqyrtim përfaqësuesi i akuzës – Prokurori i Shtetit, me rastin e leximit të aktakuzës, paraqitjes së fjalës hyrëse e deri në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënim sipas ligjit.

Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që e ngarkon aktakuza. Gjyqtarja e vetme gjykuese ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjendja e këtillë faktike u vërtetua përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- Raporti fillestar i policisë;
- Letërnjoftimi dhe patentë shoferi i të pandehurit, origjinal dhe në kopje;
- Shkresat nga Agjencia e Regjistrimit Civil së Republikës së Kosovës;
- Shkresat nga MPB;

- Njoftimi nga ambasada Polake në Shkup, AMB.SKOP.52124.4.2019 e datës 15 Maj 2019, kanë njoftuar se patentë shoferi me numër.... në emër të N.B i lindur me datë 29.08.1963 nga Komuna Shtime;

-Flete aplikimi në qendrën e patentë shofereve,

-Kopja e patentë shoferit të Polonisë,

-Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të patentës së Republikës së Kosovës,

-Patentë shoferi i Republikës së Kosovës;

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht gjykata vlerëson si të pakontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

- se zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme – Sektori i patentë shoferëve kanë verifikuar vërtetësinë e patentë shoferit të të akuzuarit dhe kanë njoftuar Agjencionin e Regjistrimit Civil se ky patentë është i falsifikuar, ku pastaj nga Ministria e Punëve të Jashtme është bërë verifikimi në Ambasadën Polake në Shkup është vërtetuar se ky patentë shofer është i falsifikuar dhe nuk ishte regjistruar në asnjë institucion atje.
- Andaj në këtë çështje penale ka qenë kontestuese vërtetimi i faktit se i akuzuari a ka qenë në njohuri se patentë shoferi me numër është i falsifikuar dhe me dashje ka dashur të legalizoj të njëjtin në institucionet tona, pasi që i akuzuari ka deklaruar se këtë patentë e ka nxjerrë në mënyrë të rregullt në Poloni në vitin 1991-1992 dhe pasi e ka legalizuar të njëjtin i është kërkuar nga zyrtarët e Policisë së Shtimes të dorëzoj atë me arsyetimin se është i falsifikuar.

Gjyqtarja e vetme gjykuese gjendjen faktike e vërtetoi duke u bazuar nga dëshmia e dëshmitares H.E, i cili ka deklaruar se punon si zyrtarë për patentë shofer të huaj në Agjencionin e Regjistrimit Civil në Prishtinë e cila ka kompetence në tërë territorin e Kosovës, ka deklaruar se kërkesa për përkthimin e patentë shoferit nga një shtet përkatës në shtetin tonë bëhet në qytetin ku qytetari ka vendbanimin si dhe nevojiten dokumentet të cilat janë të domosdoshme për aplikim, në rastin konkret tek i akuzuari pasi që kanë verifikuar dokumentet

e kërkuara kanë konstatuar se dokumentet janë në rregull por jo sa i përket vërtetësisë së tyre por vetëm në aspektin procedural.

E njëjta shton se në vitin 2017 kur ka ndodhur rasti, Agjensioni nuk ka pasur kompetencë të verifikoj vërtetësinë se a janë legal patentë shoferet e huaj mirëpo pas rritjeve të rasteve të tilla është arritur një marrëveshje me zyrtaret e policisë së Kosovës dhe tash kanë edhe këtë kompetencë.

Gjithashtu shton se pasi i akuzuari ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për legalizimin e patentë shoferit të njëjtin e kanë dërguar për prodhim dhe të akuzuarin e kanë pajisur me patentë shofer, mirëpo nga ana e zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme – Sektori i patentë shoferëve është verifikuar vërtetësia e patentë shoferit të të akuzuarit dhe kanë njoftuar Agjencionin e Regjistrimit Civil se ky patentë është i falsifikuar, ku pastaj nga Ministria e Punëve të Jashtme është bërë verifikimi në Ambasadën Polake në Shkup është vërtetuar se ky patentë shofer është i falsifikuar dhe nuk ishte regjistruar në asnjë institucion atje, më pas është njoftuar Stacioni Policor Shtime ku i akuzuari ka vendbanimin dhe i është sekuestruar patentë shoferi me arsyetimin se i njëjti ka dashur ta legalizoj atë edhe pse ka qenë i nxjerrë në mënyrë ilegale.

Gjykata me kujdes të veçantë ka analizuar të gjitha këto prova që janë administruar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor dhe atë secilën veç e veç dhe të ndërlidhura me veti.

Fillimisht gjykata ka analizuar dhe trajtuar me kujdes të veçantë dëshminë e dëshmitares H.E dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku gjyqtarja e vetme gjykuese i ka vlerësuar si të besueshme e cila përmban një përshkrim në hollësi të procedurës për legalizimin e një dokumenti në shtetin tonë të lëshuar nga ana e shteteve të tjera dhe se si është vërtetuar se patentë në fjalë ka qenë i falsifikuar dhe i akuzuari ka arritur ta legalizoj atë në zyrën e regjistrimit civil në Komunë të Shtimes, e të gjitha këto dëshmisë së saj i japin kredibilitet dhe tregojnë vërtetësinë e saj.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari gjatë mbrojtjes së tij ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar duke theksuar se gjatë vitit 1991 deri në vitin 1992 ka jetuar në shtetin e Polonisë dhe në mënyrë të rregullt ishte lajmëruar në auto shkollë dhe kishte kryer të gjitha procedurat për tu pajisur me patentë shofer, këto procedura i kishte përfunduar në qytetin e Katovicës si dhe kishte paguar një shumë rreth 200 marka.

I njëjti ka deklaruar se gjatë vitit 2017 kishte shkuar në qendrën e regjistrimit për ta bërë përkthimin e patentë shoferit pasi që i kishte përfunduar këto procedura dhe ishte pajisur me patentë shofer të Kosovës, mirëpo pas një kohe nga ana e zyrtareve të ministrisë ishte njoftuar se patentë shoferi ishte i falsifikuar dhe nuk ishte regjistruar në asnjë institucion, gjithashtu shton se deri në vitin 2017 ka vozitur me patentë shofer të Polonisë pasi ka punuar shofer, dhe disa herë ka tentuar ta përkthejë atë po nga ana e zyrtarëve të agjencisë së regjistrimit civilë në Shtime është njoftuar se ende nuk ka filluar procedura e legalizimit të dokumenteve të huaja dhe pasi kishte kuptuar se ka filluar legalizimi i tyre kishte aplikuar për ta përkthyer patentën dhe ishte pajisur me patentë shofer të R. Së Kosovës.

E njofton gjykatën se rreth 2 viteve nuk posedon patentë shofer, edhe pse të njëjtin e kishte marrë në mënyrë të rregullt mirëpo pas një kohe është njoftuar nga ana e zyrtarëve të Ministrisë se patentë shoferi i Polonisë ishte i falsifikuar dhe i njëjti ka legalizuar atë edhe pse e ka ditur që të njëjtin nuk e ka nxjerrë në mënyrë të rregullt, pastaj është ftuar nga ana e Policisë së Kosovë – Stacioni Policor në Shtime që të shkojë të jep deklaratë dhe i është marrë patenta me arsyetimin se i njëjti e ka legalizuar një dokument të falsifikuar.

Vlerësimi i mbrojtjes të të pandehurit

Gjykata çmoj dhe vlerësoj mbrojtjen e të akuzuarit se gjatë vitit 1991 deri në vitin 1992 ka jetuar në shtetin e Polonisë dhe në mënyrë të rregullt ishte lajmëruar në auto shkollë dhe kishte paguar procedurat për tu pajisur me patentë shofer, këto procedura i kishte përfunduar në qytetin e Katovicës si dhe kishte paguar një shumë rreth 200 marka gjithashtu patentë shoferi ishte marrë në mënyrë të rregullt nga institucionet e shtetit tonë dhe me të njëjtin patentë kishte vozitur rreth 2 vite.

Mirëpo, gjyqtarja e vetme gjykuese duke u bazuar në provat materiale dhe atë: njoftimi nga Ambasada Polake në Shkup, AMB.SKOP.52124.4.2019 e datës 15 Maj 2019, të cilët kanë njoftuar Ministrinë e Punëve të Jashtme se patentë shoferi me numër 195128 në emër të N.B i lindur me datë... nga Komuna Shtime, nuk është nxjerrë në asnjë nga Institucionet e shtetit Polak, duke e njoftuar shtetin tonë se ky patentë shofer është i falsifikuar, andaj nga të gjitha të lartcekurat dhe bazuar në këtë nuk i fali besimin mbrojtjes së të pandehurit i cili ka për qëllim të i ikë përgjegjësisë penale pasiqë i njëjti gjatë mbrojtjes së tij vetëm ka deklaruar se nuk i kujtohet saktë se në cilin institucion ka aplikuar për patentë shofer pasi ka kaluar një kohë e gjatë duke treguar vetëm qytetin e Polonisë ku i ka përfunduar procedurat, mirëpo me asnjë

provë të vetme nuk e ka bindur gjykatën se këtë patentë e ka nxjerrë në mënyrë të rregullt, ndërsa me të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës gjykata ka vërtetuar se i akuzuari në zyrat kompetente të Komunës së Shtimes ka arritur të legalizoj patentë shoferin e shtetit të Polonisë duke u pajisur me patentë shoferin e shtetit tonë, edhe pse ai dokument sipas Ambasadës Polake nuk është i regjistruar në institucionet e tyre andaj është i falsifikuar.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të të akzuarit

Por, gjykata vlerëson se në rastin objekt gjykimi, provohet përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën legalizim i përmbajtjes se rreme nga neni 403 par.1 të KPRK-ës, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi, në zyrën për patentë shofer në Shtime, i pandehuri ka vënë në lajthim organin kompetent në atë mënyrë që ka prezantuar një dokument publik dhe ka arritur të vërtetojë një çështje të pavërtetë, ku i pandehuri ishte i pajisur me patentë shofer të Polonisë me nr.... të njëjtën patentë shofer kishte arritur ta bëj përkthimin në patente shofer të Republikës së Kosovës me nr.... dhe pas verifikimit nga Ambasada Polake në Shkup ka rezultuar se ky patentë shofer është i falsifikuar dhe nuk ishte regjistruar në asnjë institucion atje, andaj nga të lartë cekurat i akuzuari është përgjegjës për këtë veprë penale dhe është shpallur fajtor për këtë veprë.

Nga interpretimi dispozitës të nenin 403 arrihet në përfundimin se: te kjo veprë penale dhënësi i dokumentit është vënë në lajthim përkritazi me saktësinë e përmbajtjes së dokumentit (d.m.th., ai nuk është i vetëdijshëm se bëhet fjalë për një dokument të pavërtetë). Për këtë arsye, kjo veprë penale nuk mund të konsiderohet si formë e vërtetë e falsifikimit intelektual. Veprimi i kryerjes qëndron në shtyrjen e organit kompetent për të legalizuar një përmbajtje të pavërtetë, gjë që nënkupton sjelljen në lajthitje të organit kompetent përkritazi me saktësinë e fakteve që i vërteton organi. Kryesi i veprës penale, me qëllim dhe vetëdije, tek organi kompetent, d.m.th., tek personi i cili është i autorizuar që, në emër të organit kompetent, të vërtetojë dokumentin publik, regjistrin (procesverbalin) a librin, krijon përfytyrim të gabuar për ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve juridike relevante. Vënia në lajthim të këto vepra mund të kryhet në mënyra të ndryshme, p.sh., me theksimin e fakteve që nuk ekzistojnë fare, me mohimin e fakteve të cilat realisht ekzistojnë, me ndryshimin e kuptimit dhe përmbajtjes së tyre, me heshtjen e fakteve apo të të dhënave etj., dhe me këtë rast është irelevante nëse deklarata, me të

cilën subjekti pasiv është sjellë në lajthitje, është dhënë me gojë apo me shkrim. Pra, objekt i veprës penale është: dokumenti publik (në kuptim të këtij inkriminimi, duhen nënkuptuar dokumentet në formë certifikate, vërtetimi apo dëftese me të cilat organi kompetent vërteton ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve të caktuara) apo regjistri (procesverbali) ose libri, si në rastin konkretë (patentë shoferi), kështu që kjo veprë penale nuk do të ekzistojë, nëse veprimi i kryerjes është ndërmarrë në dokumentin privat.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tersi pranë akuzës dhe provave që mbështesin aktakuzën, të cilat prova e përbëjnë këtë çështje penale e që të njëjtat janë nxjerre në procedurën hetimore dhe gjate seancave të gjyqimit, ku të njëjtat vërtetojnë gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitivin e kësaj aktakuze, e që kjo gjendje faktike se i akuzuarit ka kryer veprën penale vërtetohet nga dëshmia e dëshmitares H.E e cila me dëshminë e dhënë ka sqaruar të procedurën lidhur me përkthimin e patentë shofer të huaj në Republikën e Kosovës si dhe vet i akuzuari në vetëmbrojtjen ka vërtetur se është pajisur me patentë shofer të Polonisë nga një auto shkollë dhe i njëjti pranoi që nuk është marrë nga një institucion shtetëror, po ashtu kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe në bazë të provave materiale të cilat janë të bashkangjitur në shkresat e lëndës.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e konsideron veten fajtor për këtë veprë penale dhe në rast se gjykata e gjen fajtor të shqiptoj një dënim sa më të butë por në rast se nuk e gjen fajtor kërkon që të kthehet patentë shoferi dhe përveç asaj që ka deklaruar në mbrojtjen e tij tjetër nuk ka se çka të shtoj.

Caktimi i dënimit për të akuzuarin

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjyqtarja i vetme gjyquese, vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, që matja e dënimit të bëhet edhe në proporcion me peshën e veprës penale dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit andaj në rastin konkret duke marrë për bazë si rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, andaj në rastin konkret nuk gjeti rrethana veçanërisht lehtësuese ndërsa si rrethanë lehtësuese vlerësoi se i akuzuari është i moshës së shtyre, i pa dënuar me parë për ndonjë veprë penale, ndërsa me rastin e vlerësimit të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi

mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale se veprimet e ka vënë në lajthim organin kompetent në atë mënyrë që ka prezantuar një dokument publik dhe ka arritur të vërtetojë një çështje të pavërtetë.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, duke vlerësuar se edhe me sanksion penal alternativ do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 i KPRK-së, i cili përcakton se *”qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra te lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryerësi të mos kryejë vepra penale”*, kështu që me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv dhe pa ekzekutimin tij do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë veprës penale dhe kryesit, që do të shërbej në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Kërkesa pasurore juridike, konfiskimi si dhe shpenzimet procedurale

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP-ës, pasi që nga të dhënat e mbledhura gjatë procedurës penale nuk kanë paraqitur bazë të sigurt për gjykim të plotë ose të pjesshëm të kërkesës pasurore juridike, pasi që pala e dëmtuar nuk ka bashkangjitur asnjë provë të vetme për të vërtetuar dëmin e shkaktuar.

Vendimi lidhur me konfiskimin e përhershëm është marrë në kuptim të nenit 115 par.2 të KPP-ës, andaj patentë shoferi i të akuzuarit i lëshuar nga R.Kosovës me numër..., i konfiskohet në mënyrë të përhershme.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 453 par. 4 të KPP-ës, i akuzuari lirohet nga detyrimi i pagesës për shpenzimet e procedurës penale, shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe taksën për kompensimin e viktimave të krimit, duke marrë parasysh gjendjen e dobët ekonomike dhe ngarkimi me shpenzime do të rrezikonte gjendjen e tij materiale apo të personave që ai detyrohet ti mbështesë materialisht.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.992/19 e datës 30 Prill 2021**

Praktikante,
Kaltrina Namani

Gjyqtarja,
Mimoza SHABANI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.